


REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep.	Nr. Prot.
Dep.	Br. Prot.
Dep.	Prot No.
Nr. Ifaq.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages	Date
PRISHTINE	

2-D/DPK      01-52/15  
02      13.01.2015



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.01.2015, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-3764-14 për z.Imer Llabjani** – Drejtor infermierik në Spitalin Rajonal Ferizaj, për shkak se është shmangur situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

**II. Rasti mund të rihapet** në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

**I. Rasti i hapur** nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-3764-14, për Zyrtarin e lartë, z.Imer Llabjani–Drejtor infermierik në Spitalin Rajonal Ferizaj dhe njëkohësisht person i autorizuar në një ndërrmarrje private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Llabjani fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit ( Z.D./DPK-01-3828/14), pas të cilës ai është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Llabjani është deklaruar se shumë shpejt do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme.

Meqenese, z.Llabjani, i ka kaluar afatet brenda e cilave është dasht të sjell njoftimin për ndryshimet, Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), konform ligjit, i ka bërë edhe shkresën e dyte zyrtare, që quhet “Paralajmëruese” (Z.D./DPK-014678-14), pas të cilës i është dhënë një afat i caktuar për të bërë ndryshimet, në të kundërten AKK do ta procedonte rastin sipas nenit 18 paragrafi 8 i Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051).

Ndërkohe në Agjencinë kundër Korrupsionit, z.Llabjani ka sjellë "Informata mbi biznesin" (DPK-03-02/16/15) nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se ai tashmë e ka shuar vullnetarisht biznesin e tij privat "Labi Kompani" dhe me këtë kashmangur situatën e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Tani, z.Llabjani, ushtron vetëm funksionin e tij publik; Drejtor infermierik në Spitalin Rajonal të Ferizajit.

**II.** Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit  
Hasan Preteni

